



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:091191
Datë: 15.07.2024
Numri i dokumentit: 05939594

Pml.nr.439/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi kryetar, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. Sh., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 18 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Asdren Hoxha, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.167/2023 të datës 13.06.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.603/2024 të datës 25.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit M. Sh. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.167/2023 të datës 13.06.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.603/2024 të datës 25.06.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr. 167/2023 të datës 13.06.2024, të pandehurit M. Sh., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë

nga neni 173 par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 18 par. 2 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me aktgjykim. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.603/2024 të datës 25.06.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit M. Sh. av. Asdren Hoxha, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitës së nenit 384 par. 2 nën par. 2.1 lidhur me nenin 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 dhe nenit 366 par. 1 lidhur me par. 3 të KPP, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të pandehurit t'i ndërprehet masa e paraburgimit dhe i njëjti të lirohet për t'u mbrojtur në liri në vazhdim të procedurës.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.185/2024 të datës 12.07.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se i pandehuri mbahet në paraburgim për një kohë tashmë shumë të gjatë, nuk ka ikur asnjëherë, por e ka thirrur me telefonin e tij policinë si dhe i ka pritur në shtëpinë ku ka ndodhur ngjarja. Po ashtu, i pandehuri ka punuar si polic i Kosovës gjer në momentin kur është kryer vepra penale, andaj nuk ekziston asnjë rrethanë e cila flet për rrezik të ikjes duke konsideruar se ky kusht ligjor nuk ekziston. Po ashtu nuk ka rrezik të përsëritjes së veprës penale, pasi që i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale, por kjo veprë është kryer në gjendje të dehur dhe si pasojë e sulmit të të ndjerit, ku në mënyrë të vazhdueshme, me presionet e tij e ka sjellë të pandehurin në gjendje të tillë, ashtu që vepra e tillë nuk ka rrezik të përsëritjes ngase kryhet vetëm një here në jetë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se i pandehuri është shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën është akuzuar, kurse a do të vërtetohen këto fakte e prova do të vlerësohet gjatë fazave të ardhme të procedurës, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1. nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ikjes, fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, pasi që të

pandehurit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej shtatëmbëdhjetë (17) viteve, e në këtë mënyrë do ta pamundëson zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë i gjen si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.439/2024, më 15.07.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi